



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 13.7, 15.1, 16.2, 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 3. 7. 2003, nenit 17 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. .03/L-040, të dt. 20 shkurt 2008, dhe të nenit 16, par. 1, shkronja **b** dhe neni 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 12.5.2009, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES
“PRISHTINA E RE - LINDJE” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Prishtina e Re- Lindje” në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik -zhvillimi urban i Prishtinës, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

Neni 3

Me Planin rregullues nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet pjesa e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar si “Prishtina e Re - Lindje”, e cila përkufizohet me territorin e fshatit Matëçan, duke përshkruar ngastrat në drejtim të Liqenit të Badocit nr.: 1219, 1229, 1242, 1243, 1244, 1245, 1246, 1247, 1248, 1249, 1250, 1411, 1257, 1258, 1260, 1263, 1264, 1268, 1269, 1271, 1272, 1273, 1277, 203, 201, 616, 615, 614, 467, 616, 466, 459, 466, 585, 587, 578, 574, 101, 40, 42, 23, 54, 55, 58, 59, 60, 17, 16, 4, 5, 6, 1, 1392, 1388, 1387, 1384, 1023, 1022, 1021, në një sipërfaqe prej 290ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës nga par. 1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Bartëse e hartimit të planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, është drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Për hartimin e Planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Komuna mund të ngarkojë agjenci dhe subjekte tjera, të specializuara dhe të certifikuara për hartimin e planeve hapësinore dhe urbane.

Drejtoritë tjera të Komunës së Prishtinës janë të obliguara që të sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për të cilat konsiderohet të jenë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i planit rregullues për hapësirën e përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat për objektet me interes publik dhe lagje të organizuara do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësinë e inkorporimit të lokacionit përkatës në Planin rregullues të këtij kompleksi.

Neni 7

Plani rregullues "Prishtina e Re - Lindje" do të jetë në harmoni të plotë dhe kooperativ me Planin rregullues "Prishtina e Re - Qendra" dhe "Prishtina e Re - Perëndim", të cilat gjatë projektimit do të mbikëqyren nga një ekip i ekspertëve të planifikimit.

Neni 8

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Pronës, të cilat do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 9

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues "Prishtina e Re" në Prishtinë 01 Nr. 35-581 dt. 27.12.2006

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr. 35-851, më 12.5.2009

KRYETARI I KOMUNËS

Prof.dr. Isa Mustafa